

MASTER PROFESIONAL NË TURIZËM

Emertimi akademik i studimit	Diplomë Master Profesional ne Turizëm
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me VENDIM Nr. 45, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i Dytë
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqipe
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	Pranimi në programin e ciklit të dytë të studimeve, “Master Profesional”, është i mundur për individët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe kanë fituar një diplomë universitare “Bachelor” në fushën e ekonomisë ose në fusha të tjera të përafërta. 1. Kriteret e pranimit të studentëve në këto programe studimi, përbëhen nga: - Kriteri i meritës. Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”. - Kriteri i rëndësisë. Koeficienti i profilit të studimeve “Bachelor” sa i akon përputhshmërisë me fushën dhe programin e studimit të Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit si më poshtë: • Për kandidatët e diplomuar në Turizëm në Universitetin e Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi për të cilin është bërë aplikimi, koeficienti do të jetë 1.0. • Për kandidatët e diplomuar në Turizëm jashtë Universitetit të Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi për të cilin është bërë aplikimi, koeficienti do të jetë 0.9. • Për kandidatët e diplomuar në ekonomi në Universitetin e Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit për të cilat është bërë aplikimi, koeficienti do të jetë 0.85. • Për kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë Universitetit të Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit për të cilat është bërë aplikimi, koeficienti do të jetë 0.8. • Për kandidatët e diplomuar jashtë fushës së

	ekonomisë , jashtë profileve të studimit për të cilat është bërë aplikimi, koeficienti do të jetë 0.7. 2. Kuotat e paracaktuara nga Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit. 3. Kandidati duhet të ketë të mbrojtur një prej 5 gjuhët e huaja në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023 (për një ndryshim në Udhëzimin Nr.52, datë 3.12.2015) , për “Përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e Arsimit të lartë, të ndryshuar” . (Niveli B1). Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin e studimit Master Profesional në “Turizëm” do të llogaritet, si më poshtë : Notë mesatare në programin e studimit “Bachelor” * koeficient (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet), duke gjeneruar një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj listë brenda kuotave të paracaktuara nga NJB për këtë program studimi. - Kandidatët e diplomuar jashtë vendit në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, janë të detyruar të kryejnë njehsimin e diplomës pranë MAS-it. Kriteret e pranimit për programet e dyta të studimit - Për Ciklin e Dytë të studimeve, nota mesatare për pranim llogaritet si mesatare e thjeshtë e : (a) mesatares së notave të ciklit të parë të studimeve, plus (b) mesataren e notave të fakultetit të parë të Ciklit të Dytë të studimeve. - Renditja e kandidatëve fitues kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri ne plotësimin e kuotave të shpallura.
--	---

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **Master Profesional në Turizëm** është të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit në tregun lokal, rajonal, kombëtar edhe më gjerë, qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera përkatëse integruese. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar:

1. Përgatitjen e plotë profesionale të studentëve si specialiste të turizmit për të gjitha subjektet private dhe publike;
2. Fitimin e njohurive të thelluara në fushën e turizmit si specialistë të aftë për të zbatuar me sukses strategjitë dhe politikat e turizmit të qëndrueshëm;
3. Aftësimin e studentëve për t'u integruar me sukses në drejtimin dhe funksionimin me sukses të të gjitha sipërmarrjeve në industrinë turistike;
4. Aftësimin e studentëve për të hartuar dhe menaxhuar produkte cilësore turistike;
5. Marrjen e njohurive të zgjeruara në lidhje me tregjet turistike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në sektorin e turizmit dhe institucioneve dhe ndërmarrjeve që operojnë në këtë sektor.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin në të cilin do të operojë si i punësuar në të ardhmen.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. Lëndë të formimit të përgjithshëm

Nr	Lëndët /Modulet	Kredite
1	Ekonomiks Menaxherial	6
2	Menaxhim burimesh njerëzore në industrinë e turizmit dhe mikëpritjes	6
	TOTALI	12

2. Lëndë të formimit karakterizues

Nr	Lëndët /Modulet	Kredite
1	Turizmi dhe trashëgimia natyrore	6
2	Turizmi dhe industria turistike	6
3	Menaxhim destinacionesh turistike	6
4	Turizmi dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri	6
5	Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm	6
6	Menaxhim i biznesit familjar në turizëm	6
7	Turizmi dhe zhvillimi rural i qëndrueshëm	6
8	Ekonomia e turizmit	6
	TOTALI	48

3. Lëndë ndërdisiplinore, integruese

Nr	Lëndët /Modulet	Kredite
1	Marketingu i turizmit	6
2	Sjellje konsumatore në turizëm	6
3	Politikat në turizëm	6
4	Menaxhim i cilësisë në turizëm	6
5	Lëndë me zgjedhje : (1)Menaxhim projektsh (2)Sistemet e informacionit të menaxhimit (3)-Marketingu i shërbimeve	6
	TOTALI	30

4. Lëndë të formimit plotësues

Nr	Lëndët /Modulet	Kredite
1	Praktika profesionale	12
	TOTALI	12

5. Detyrime përmbyllëse

Nr	Lëndët /Modulet	Kredite
1	Detyrime përmbyllëse	18
	TOTALI	18

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të dyë **Master Profesional në Turizëm** mundëson zhvillimin e mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ofron punësimi në sektorin turistik. Studenti i cili diplomohet në programin e Master Profesional në Turizëm mundet të vazhdojë studime më të thelluara në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në turizëm apo në një fushë të ngjashme, bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë në sektorin turistik. Nëpërmjet këtij programi synohet formimi shkencor dhe profesional i studentëve që të bëhen drejtues, ekspertë dhe konsulentë të aftë në sektorin turistik.

Në përfundim të këtij programi, studenti do të jetë në gjendje që:

- të realizojë një formim të plotë për të ushtruar profesionin e specialistit në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të turizmit;
- të punojë si specialist turizmi në subjekte private dhe publike;
- të drejtojë, kontrollojë dhe menaxhojë veprimtarinë e një ndërmarrje turistike;
- të organizojë paketa turistike në përputhje me kërkesat e subjekteve turistike publike dhe private;
- të përgatisë evidenca të plota statistikore mbi treguesit e lëvizjes turistike, treguesit cilësorë etj;
- të kryejë analiza të lëvizjes turistike dhe të japë rekomandime për përdoruesit e këtij informacioni;
- të jetë i aftë të rekomandojë zhvillimin e llojeve të turizmit më të përshtatshme në rajonin përkatës;
- të ketë njohuri kompetitive për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm;
- të njohë dhe të aplikojë në praktikë sistemet e informatizuara në shërbim të turizmit;
- të bashkëpunojë dhe koordinojë punën për të zbatuar strategjitë kombëtare dhe rajonale të turizmit.

Në përfundim të këtij programi, studenti ka mundësi për punësim si:

- Në sipërmarrje private turistike;
- Në biznese që ofrojnë shërbime turistike;
- Në biznese ndihmëse turistike;
- Në zyra dhe agjensi turistike;
- Në sektorin publik.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Ekonomiks menaxherial	6	60	I
2.	Menaxhim burimesh njerëzore në industrinë e turizmit dhe mikëpritjes	6	60	I
3.	Turizmi dhe trashëgimia natyrore	6	60	I
4.	Turizmi dhe industria turistike	6	60	I
5.	Marketingu i turizmit	6	60	I
6.	Menaxhim destinacionesh turistike	6	60	II
7.	Turizmi dhe trashëgimia kulturore në Shqipëri	6	60	II
8.	Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm	6	60	II
9.	Sjellje konsumatore ne turizëm	6	60	II
10.	Politikat në turizëm	6	60	II
Gjithsej viti i parë		60	600	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Menaxhim i biznesit familjar ne turizëm	6	60	I
2.	Turizmi dhe zhvillim rural i qëndrueshëm	6	60	I
3.	Ekonomia e turizmit	6	60	I
4.	Menaxhim i cilesisë ne turizëm	6	60	I
5.	Praktika Profesionale	12	300	II
6.	Lëndë me zgjedhje			
	-Menaxhim projektesh -Sistemet e informacionit të menaxhimit -Marketingu i shërbimeve	6	60	I
7.	Punim diplome/ Provim përfundimtar	18	50	II
	Gjithsej viti i dytë	60	650	
Total : Viti I + Viti II		120		